

PËRQASJE KRIJIMTARISË GOJORE SHQIPTARE TË BOTUAR NGA TJETRI

Leontina GEGA - MUSA
Instituti Albanologjik
Prishtinë

Punim studimor

Përmbajtje e shkurtër: Kultura tradicionale shqiptare u bë objekt i kërkimeve etnofolklorike për shumë udhëpërshkrues, misionarë, studiues, shkrimtarë, antropologë e konsuj të ndryshëm që qëndruan gjatë shekullit XIX në Ballkan. Shkrimet e botuara të këtyre misionarëve dhe personaliteteve të kulturave të huaja për historinë e kulturën shqiptare në atë kohë, qofshin në gjuhën angleze, qofshin në gjermane apo frënge, u bënë bazë për fillimin e ngritjes së albanologjisë, jo vetëm në aspektin gjuhësor e historik, por edhe në atë të kulturës tradicionale.

Në këtë punim do të trajtohet kontributi i dy albanologëve të huaj, ai i mjekut dhe filologut gjerman Karl Heinrich Theodor Reinhold me botimin “Noctes pelasgicae” botuar në vitin 1855, në Athinë dhe ai i konsullit francez August Dozon, me botimin “Manuel de la Langue Chkipe ou Albanaise” botuar në vitin 1879, në Paris. Qëllim i risjelljes së këtyre dy botimeve albanologjike në fokus trajtimi është se, ato pos që kanë në radhë të parë të përbashkët analizën në aspektin filologjik, konkretisht të dialektit jugor të shqipes, njëkohësisht përmbajnë edhe materiale empirike të kulturës tradicionale, nga të cilat mëtojmë të shkoqisim disa nga ato krijime gojore që bartin vlera përmbajtësore për folkloristikën shqiptare, si dhe cili është trajtimi që u është bërë këtyre krijimeve nga këndvështrimi i tjetrit, qofshin nganjëherë edhe të nxituar me konkludimet që sjellin mbi bazën e një materiali të kufizuar empirik, sidomos për atë kohë dhe hapësirë të caktuar ku janë mbledhur ato njësi folklorike.

Hyrje

Ballkani dhe kulturat e popujve që jetojnë në këtë region, gjatë shekullit XIX, zgjuan interesim të theksuar të personaliteteve të kulturave të ndryshme evropiane, qofshin ata udhëpërshkrues, qofshin misionarë, studiues, shkrimtarë, antropologë e konsuj, të cilët e vizituan dhe qëndruan për një kohë në këto vise. Ndër këto personalitete, që lanë shënime të konsiderueshme edhe për kulturën, gjuhën, mënyrën e jetesës dhe zakonet e historinë e shqiptarëve, ishin poeti anglez George Gordon Byron-i, Lordi Beaconsfield-i, John Cam Hobhouse e William Martin Leake. Ky interesim që më i theksuar në mesin e personaliteteve gjermane e austriake, si: Karl Reinhold-i, Gustav Meyer-i, Franz Nopcsa, Joseph Xylander-i, Franz Bopp-i, Johann Georg von Hahn-i. Për kulturën shqiptare shprehën interesim edhe francezët, si: shkrimtari e diplomati François-René de Chateaubriand-i, François Pouqueville, konsulli i Francës në Shkodër Louis Hyacinthe Hecquard-i, P. Lavardin-i, A. Dozon-i, A. Boué, A. Jaray, J. Degrand-i, e shumë të tjerë.

Interesimi për kulturën shqiptare nga këto personalitete evropiane rreth mesit të shekullit XIX, në kohën e përballjeve të ndryshme politike e ideologjike në Evropë, po edhe në Ballkan, i cili pjesërisht ende ishte nën Perandorisë Osmane, dominohet kryesisht rreth origjinës së etnisë dhe shtrirjes kulturore të saj në treva të caktuara si territor historik. Shkrimet që u botuan nga hulumtimet e realizuara për këto qëllime nga këto personalitete kryesisht u mbështetën mbi paradigmen gjermane me të cilën ‘në njërin anë u hodhën themelet e një shkolle mbi tjetrin e, në anën tjetër, mbi veten’.¹ Me anë të një rishikimi kritik që bën antropologu Doja të dhënave për historinë e studimeve në gjuhë gjermane, të njohur si *Albanologie*, sidomos të studimeve që lidhen me traditën folklorike dhe etnografike, historinë, filologjinë, arkeologjinë, antropologjinë fizike e disiplinave të ngjashme, ky interesim i theksuar konsiderohet si i nxitur nga ‘paradigma gjermane e *Volkskunde*-s’ e cila si term i referohet sistematikisht mospranimit të gënjeshtërs dhe nostalgjisë së traditave të vjetruara piktoreske, si diçka që fillimisht aplikohet vetëm për zonat ru-

¹ *Kosova antropologjike*, edituar nga Nebi Bardhoshi, Arsim Canolli (Tiranë: Akademia e studimeve albanologjike, Instituti i antropologjisë kulturore dhe i studimit të artit, 2020), f. 12, si dhe Nebi Bardhoshi, Arsim Canolli, “Kosova antropologjike”, në *Albanologji* 1/11-2020 (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2021), f. 332.

rale dhe fshatarët e varfër dhe analfabetë. Por, varësisht nga qasja e studimit, krahas termit *Volkskunde* në gjuhën gjermane përdoret edhe termi *Völkerkunde*, për dallimet e të cilave terme studiuesi Doja thekson, se

“...dolën nga tradita historiciste e muzeumeve në të cilën *Völkerkunde* kishte të bënte me historinë kulturore të të tjerëve të jashtëm, ndërsa *Volkskunde* me të tjerët historikë të traditës kulturore kombëtare. Më shumë se thjesht një vijë ndarëse ndërmjet tyre, nënkuptohet një ndarje plotësuese e punës midis tyre, dhe të dyja kanë kontribuar në konstruktimin e “tjetrit” brenda dhe jashtë Evropës. Ato nuk u zhvilluan gjatë kohës së ekspansionit perandorak sikur etnologjia në Francë dhe antropologjia në Britani, por gjatë kohës së aspiratave perandorake (pruste). Nëse në kontekstin nacional modeli historicist i traditës folklorike (*Volkskunde*) çonte në nocionin e Herderit mbi “shpirtin e popullit” (*Volksgait*), në kontekstin e ri kolonial modeli i traditës shkencore natyraliste (*Völkerkunde*) çonte në rivitalizimin e vazhdueshëm të nocionit të Herderit mbi popujt primitivë ose “natyrorë” (*Naturvölker*) me pak ose aspak kulturë e histori, të cilët kështu mund të zbulonin natyrën e vërtetë njerëzore”².

Megjithatë, edhe përkundër qëndrimit teorik e praktik që duhet mbajtur ndaj njërive gjuhësore, folklorike dhe shënimeve etnografike, të mbledhura dhe të botuara prej të huajve, qasja dhe trajtimi i këtyre studimeve brenda kategorive tradicionale dhe ‘në mënyrë skematike brenda një perspektive të thjeshtë historiciste’³, ofron informacion historik dhe të dhëna për kulturën shqiptare të asaj kohe. Ndër këto botime, shquhet vepra poliedrike e Johann Georg von Hahn-it “Studime shqiptare” në tri vëllime, botuar në Jena, më 1854, e cila u bë mbështetje referenciale për hulumtimet e mëpasme albanologjike. Në mesin e albanologëve të huaj, për të cilët vepra e Hahnit, u bë grishje dhe referencë studimore për studimet e tyre që u botuan më vonë, janë edhe Karl Heinrich Theodor Reinhold-i dhe August Dozon-i. Qëllimi i trajtimit në mënyrë të veçantë të këtyre studimeve në këtë punim është se ato janë

² Albert Doja, Lindja e Albanologjisë sipas shkrimeve gjermane dhe austriake, *Gjurmime Albanologjike, Folklor dhe etnologji*, 46/2016 (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2016), f. 9-39, si dhe më gjerësisht Albert Doja, *Shfaqja e antropologjisë në Shqipëri*, përgatitur nga Enika Abazi (Tiranë: Akademia e shkencave e Shqipërisë, 2018), f. 121-149.

³ Albert Doja, *Shfaqja e antropologjisë...*, f.149.

botuar në intervale kohore të ndryshme dhe në gjuhë të ndryshme, por që kanë të përbashkët parimin metodologjik dhe konceptet në fushën përkatëse studimore, që në saje të shembujve nga materialet konkrete empirike, kryesisht të një dialekti jugor të shqipes, t'i shqyrtojnë ato në radhë të parë në aspektin filologjik. Ndërsa, botimi dhe studimi i krijimtarisë gojore shqiptare në to, mund të jenë vetë vlerat tekstore për nga rëndësia e formësimit dhe të shqiptimit të botëkuptimit të një bote që i përket vetëm asaj, lashtësia tematike dhe e motiveve bashkë me elementet pagane e mitologjike, si dhe ngjasimet dhe përkimet me krijimtaritë më të vjetra gojore të popujve të tjerë të Ballkanit dhe të Evropës⁴.

Karl Heinrich Theodor Reinhold-i dhe interesimi i tij për krijimtarinë gojore arbëreshe

I frymëzuar nga antikiteti që ofron Ballkani Jugor, por edhe nga vargjet e Bajron-it, mjeku gjerman nga Gëtingeni, Karl Heinrich Theodor Reinhold-i, më vitin 1834, u angazhua në flotën mbretërore të Ottos së Bavarisë, mbret i parë i Greqisë së pavarur⁵. Ky mjek dhe filolog gjerman, njohës i shkëlqyer i shtatë gjuhëve, ndër të cilat edhe i greqishtes së vjetër e të re, u tërhoq nga një gjuhë tjetër e fshatrave të Peloponezitetit dhe e ishujve përreth, të cilën gjuhë e njohu fillimisht në anije. Sipas dëshmisë së Gustav Meyer-it në "Albanesische Studien V", i cili në vitin 1896 qëndroi në Greqi për të verifikuar regjistrimet e Reinhold-it, theksohet se "si në marinën luftarake, ashtu edhe në atë tregtare, gjuha e komunikimit të detarëve e oficerëve është më së shpeshti shqipja"⁶.

Siç shprehet vetë Reinhold-i, nxitjen për studimin dhe mësimin e gjuhës shqipe e mori nga bashkëjetesa me këta detarë e fshatarë, të cilët u bënë shkas i grumbullimit të materialeve të bollshme gjuhësore e folklorike. Një pjesë të këtyre dorëshkrimeve i botoi në vitin 1855 në Athinë,

⁴Anton Berisha, Fillet e njohjes së letërsisë gojore shqipe në gjuhën gjermane, *Gjurmime albanologjike, Folklor dhe etnologji, Nr. 15 - 1985*, (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1986), f. 10-11.

⁵*Netë Pellazgjike të Karl Reinholdit*, Tekste të vjetra shqipe të Greqisë, mbledhur nga Karl Reinholdi 1850-1860, transkriptuar e shpjeguar nga Ardian Klosi, Tiranë: K&B, 2005; si dhe *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, 1635-1912*, vëllimi I, (Tiranë: Instituti i Folklorit, 1961), f. 91-118.

⁶*Netë pellazgjike...*, f.10.

në një libër me titull “Noctes pelasgicae” (Netët pellazgjike), të ndarë në tri pjesë: një kapitull gramatike, një glosar dhe një antologji këngësh e vargjesh të shkëputura. Në parathënien e këtij libri, Reinhold-i cek se çytje për këtë botim mori nga vepra e Hahn-it dhe konsideron se botimi i tij është si ‘një lloj midhjeje që i shtohen darkës së begatë të Hahn-it, e cila me të merr kundërmimin e këndshëm të detit, ndërsa pa të mbetet e rëndë për stomakun dhe e patretshme’⁷. Edhe pse në këtë parathënie ai premtim botimin edhe të një fjalorthi, si dhe të një glosari të Botanikës e Zoologjisë, përveç botimit “Netët pellazgjike” dhe një dorëshkrimi të shumëfishuar në disa kopje, të cilat gjenden në bibliotekat e Gracit, My-nihut e Venedikut, me titull “Pellasgjika”, nuk arriti të botojë më asgjë. Dorëshkrimet e Reinhold-it patën fatin që të kalojnë nga dora në dorë të disa gjuhëtarë, si Teza, Meyer-i e Weigand-i, për të përfunduar në bibliotekën “Marciana” të Venedikut dhe në Arkivin e Shtetit Shqiptar.

Reinhold-i në mbledhjen e materialeve me krijimtari gojore u ndihmua nga miku i tij, prifti Vasil Saqelari, që e njohu në flotë dhe i cili i dorëzonte rregullisht tekste shqipe, në radhë të parë si mbledhës folklori për këngë, përralla, anekdota, gjëgjëza etj., por edhe si krijues i dialogëve dhe shqipërimeve të disa nga tekstet e dhëna. Korrektësinë e priftit Saqelari në shënimin e këtyre materialeve Klosi e vlerëson si ‘skrupulozitet të tij folologjik’. Por, një mirënjohje për këtë punë e shpreh edhe vetë Meyer-i në parathënien e vëllimit V, ku thekson se “pjesa më e madhe e këtyre teksteve është nxjerrë nga trashëgimi i albanologut të njohur Teodor Reinhold-it ... Tekstet në prozë dhe në poezi janë, në pjesën më të madhe të tyre, si tentativë nga dialekti shqiptar që flitet në ishujt Poro, Hidra dhe Specia ...”. Me qëllim që ta arsyetojë vënien dorë në këto materiale, Meyer-i më tutje do të shtojë, se “... Me ndihmën e dy personaliteteve, që ishin nga Hidra e Poro-ja, kam përmirësuar disa pasazhe, por jo shumë, nga tekstet e Reinhold-it”⁸.

Materialet folklorike në “Noctes pelasgicae”

Nga materialet folklorike në “Noctes pelasgicae” të Reinhold-it, më karakteristike si nga aspekti përmbajtjesor, i imazheve e peizazheve

⁷ *Netë pellazgjike...*, f. 239.

⁸ *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635 - 1912)*, f. 437-438.

dhe mbi të gjitha i koloritit të elementeve shprehëse të krijuesit gojorë, na shfaqen këngët lirike të dashurisë. Autenticiteti i ambientit që hasim në këto këngë i takojnë një ambienti rural e bregdetar. Ashtu si në tërë liri-kën e krijimtarisë gojore shqiptare, edhe në këto këngë ambienti rural është kudo i pranishëm dhe ky ambient bën kushtëzime jo vetëm sociale dhe ekonomike për njeriun që gjallon në të, por gjithashtu edhe ndikon dhe pasqyrohet edhe në sferën e shijes estetike për të bukurën⁹.

Në këtë ambient dominon botëkuptimi, psikologjia, mentaliteti dhe dëshira e një të riu, jeta e të cilit është e lidhur ngushtë me punët bujqësore e blegtorale, me bazën materiale që sigurohet nga këto punë. Prandaj dëshira e tij, që nusja “të jetë e kuqe”, “e shkurtërë”, me “sy të zi”, “e bukurë” dhe “gjithë të qeshë”, si shprehje e shijes ndaj të bukurës në jetë, ajo të ketë edhe “shumë pajë ... dhën e dhi ... pendë kafshë edhe shtëpi”; “të ketë rgjëntëri e shumë ara”, por edhe “mëmë e tatë ... vjezër e motra”, pra të jetë “me shtëpirazë të plota”, dëshmojnë vartësinë reciproke të të gjitha këtyre komponentëve për një jetë të lumtur në ambientin rural.

Karakteristikë tjetër e këtyre krijimeve gojore erotike është se ato përshkohen prej një humori të lehtë, por vende-vende edhe mjaft therës, sidomos nëpërmjet të një varg makaronizmave që përdoren në to. Njëra nga këto këngë, e cila është pjesë e këtyre materialeve, është një këngë shumë e njohur gjer në ditët tona “Kur më vjen burri nga stani; Puf, puf, puf më bën fustani”¹⁰.

Vështruar nga aspekti përmbajtjesor, e përbashkëta e këtyre krijimeve lirike është se në to, dominon topika *deti*, si realitet i ambientit natyror, me të cilin jeta e banorëve është e lidhur ngushtë, prandaj shumë elemente të shprehjes figurative lidhen edhe me të dhe me anijen ose me ndonjë pjesë të saj. Por ka edhe të tilla, si në njërin nga këto këngë, ku pas një dialogu që zhvillon Dhimitri me të dashurën e vet, asaj i premtan se do të punojë të fitojë para që mandej të blejë “një pendë qe për të mbjellë grurë e elb”. Ai është i gatshëm të punojë edhe “te i huaji” vetëm e vetëm “prë të blë di a tre bual,/çëm’ata do shqierdhenë,/si timoni shqierdenë.”¹¹. Në këtë këngë qartë gërshetohet nota erotike me notën sociale, si dy elemente që janë në varësi në mënyrë reciproke për ta siguruar lumturinë. Ndërkaq krahasimi si figurë stilistike e gjuhës poeti-

⁹Zymer Neziri, Poetika e krahasimit erotik për vashën në këngën popullore shqiptare të dashurisë, *Gjurmime albanologjike, Folklor dhe etnologji, Nr. 17-1987*, (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1998), f. 128.

¹⁰*Netë pellazgjike ...*, f. 261.

¹¹*Netë pellazgjike ...*, f. 263.

ke, i takon rrafshit krahasues me botën e sendeve, respektivisht lëvrimi i tokës me buaj i përngjan timonit që e çan detin.

Krahasimi është njëra ndër figurat më të vjetra e më të shpeshta në këngët e dashurisë, me mundësi të mëdha të pasqyrimit artistik të jetës, të idealit dhe të shijes për të bukurën dhe për t'i përjetuar ndjenjat e dashurisë, bukurinë shpirtërore e fizike të të dashuarve në unitet të pandashëm¹². Figura e krahasimit në këto krijime poetike gojore haset edhe në rrafshet e ndryshme krahasuese, prej atyre më të thjeshtave, apo më të kursyerave, e deri te ato më emocionueset e me shtrirje të llojit të similitudave, si te vargjet: “Mor e bardha si pumbak,/qasu të të puth ndë bark!”¹³, që për kah imagjinata krijuese janë të varfra, por që kah aspekti poetik ndërliiden me realitetin e jetës dhe bëhen mjaft funksionale.

Përveç humorit dhe një natyralizmi të hapët që hasim në këto krijime që për kah numri i vargjeve janë mjaft të shkurtra, të gjitha krahasimet, madje edhe metaforat, janë të rrafshit krahasues nga bota bimore (molla, jargavani, manushaqja, shalqiri, liri, qershia), nga bota shtazore (thëllëza, ngjala e ndonjë tjetër), nga bota e sendeve (gjemi korfuzi, gajtani, filxhani, qiriri, kutia, inxhia) dhe të rrafshit kozmik (dielli, hëna), por që në to hasen shpesh edhe personifikimi dhe apostrofa.

Në mesin e materialeve folklorike të dorëshkrimeve të Reinhold-it në botimin e Klosit, janë të botuara edhe 47 gjëegjëza. Për këto gjëegjëza është karakteristike se mbledhësi jep edhe përshkrimin e kontekstit të mjedisit, në formë dialogu ndërmjet prindit që i parashtron gjëzat dhe fëmijëve që mundohen të japin përgjigje të saktë, madje edhe të shpërblehen. Gjëegjëzat e parashtruara në këtë mënyrë theksojnë jo vetëm funksionin edukativ që e kanë, por edhe funksionin e bastit, funksion ky i njohur për këtë zhanër qysh nga fazat fillestare të formimit të tij. Prej 47 gjëegjëzave, sa janë botuar në këtë përmbledhje, në formë të vargut janë shënuar vetëm katër sosh.

Gjithashtu, në këtë botim, si materiale folklorike nga dorëshkrimet e Reinhold-it janë përfshirë edhe 11 anekdota dhe rreth 140 fabula të Ezopit shumica e të cilave janë të botuara nga Meyer-i dhe Teza.

Rëndësia e botimit “Noctes pelasgicae” dhe e dorëshkrimeve të Reinhold-it, krahas gjuhësisë dhe folkloristikës shqiptare, qëndron në dëshminë e një kulture shpirtërore dhe gjuhësore të një pjese të popullsisë së steresë dhe banorëve të vetëm të një numri të ishujve të Greqisë, si:

¹² Neziri, Poetika e krahasimit ..., f. 127-128.

¹³ *Netë pellazgjike ...*, f. 242.

Hidra, Poros, Specias, Andros, Salamina etj., banorët e të cilëve ishuj, vlerësuar sipas historianëve e filologëve të ndryshëm, deri në shekullin XX e quajtën veten arbëreshë.

August Dozon-i, misioni konsullor dhe interesimi i tij për kulturën tradicionale në Ballkan

Ardhja për herë të parë në Ballkan për August Dozon-in, lidhet me vitin 1854 kur edhe u emërua kancelar i konsullatës franceze në Beograd. Kjo pozitë, i mundësoi mësimin e gjuhës serbe dhe kontakte me personalitete të kohës, me të cilët krijoi edhe miqësi, si me folkloristin serb Vuk Karaxhiç-in. Prirja e Dozon-it për poezinë, ndikoi që ai të shfaqte një interesim të shtuar për kulturën dhe traditën popullore serbe, interesim i cili u shtua më vonë edhe për popuj të tjerë në Ballkan, sidomos gjatë shërbimit të tij konsullor në vise të tjera. Nga qëndrimi i tij në Beograd, ku edhe mblodhi krijime folklorike serbe, Dozon-i i shtyrë edhe nga Karaxhiç-i botoi në vitin 1859, në Paris, përmbledhjen “Poezia popullore serbe”¹⁴.

Sipas studiuesit Jup Kastrati në botimin “Historia e Albanologjisë”¹⁵, Vuk-u ishte edhe ‘albanisti’ i parë serb (term ky që sipas Dozon-it do të duhej tentuar të përdorej)¹⁶ dhe i cili u interesua dhe mblodhi këngë të folklorit shqiptar me kërkesë të mikut të tij Jernej Kopitar-it. Nisur nga kjo e dhënë, Dozon-i do të ketë qenë në dijeni për krijimtarinë gojore shqiptare, por që studimin për të e ka realizuar vetëm pas shërbimit të tij si konsull në Janinë. Rama konsideron se mosqëndrimi i Dozonit në këtë kohë edhe në veriun shqiptar bëri që në botimet e tij “... të mos kishin zënë një vend të dukshëm perlat e eposit shqiptar, këngët e Mujit dhe

¹⁴ Për konsullin francez të Janinës, si personalitet i kulturës franceze, është botuar në vitin 2014 në Tiranë, monografia “*Shqipëria e konsullit August Dozon*” me autor Luan Rama, në të cilën autori në mënyrë harmonike gërshetohen të dhënat për jetën dhe veprimtarinë studimore të Dozonit. Kjo monografi, e bazuar në të dhëna referencash historiko-kulturore, pasqyron në mënyrë kronologjike jetën dhe qëndrimin e Dozonit në viset shqiptare dhe më gjerë në Ballkan, me theks të veçantë në veprimtarinë e tij diplomatike, politike, shkencore, gjuhësore, folkloristike, kulturologjike e arkeologjike.

¹⁵ Jup Kastrati, *Historia e Albanologjisë* (Tiranë: Botimet LMG-Shtëpia e librit, Fondacioni Soros, 2000).

¹⁶ Luan Rama, *Shqipëria e ...*, f.21.

Halilit, vaji a kënga e Ajkunës dhe Ago Ymerit, ...”¹⁷ dhe të cilat në atë kohë robërie nuk u bënë të njohura për kulturën perëndimore, pos pas rreth një shekulli. Ndoshta kjo mund të jetë edhe një nga arsyet që Dozon-i shumë vite më vonë, gjatë shërbimit të tij konsullor në Larnaka të Qipros, konkretisht në vitin 1880, t’i bëjë një kërkesë Ministrisë të Arsimit dhe Arteve të Bukura të Francës, për të financuar qëndrimin e tij në veriun shqiptar, i cili do t’i shërbente për vazhdimin e studimeve të tij.

Misioni i tij i ardhshëm në Plovdiv të Bullgarisë, i mundësoi Dozon-it që ta zgjerojë interesimin e tij edhe për kulturën dhe mësimin e gjuhës bullgare. Gjatë këtij qëndrimi dhe me kontaktet që pati me intelektualë vendës, ai hartoi përmbledhjen “Chansons bulgares inédites” (Këngë bullgare të pabotuara). E veçanta e këtij botimi për folkloristikën shqiptare është se Dozon-i me anë të krahasimit që u bën versioneve të ndryshme ballkanike të baladës *Udhëtimi i të vdekurit*, motiv ky aq i përhapur në krijimtarinë gojore bullgare, serbe, greke e shqiptare, na dëshmon se ai ka njohuri dhe interesim edhe për krijimtarinë gojore shqiptare. Versioni shqiptar i kësaj balade, të cilën e bëri të njohur De Rada me botimin “Rapsodi të një poeme shqiptare” botuar në vitin 1866, dëshmon se Dozoni kishte në dorë këtë botim, sidomos me faktin se versionin e këngës së *Kostandinit dhe Garentinës*, ai e botoi të përkthyer në frëngjisht më vonë edhe në botimin e tij. Sado që kjo baladë bart motiv të përbashkët, krahasimi i versioneve të saj shpërfaq edhe veçoritë etnokulturore të popujve që u përkasin. Edhe në variantet ballkanike të krahasuara në përmbledhjen e Dozonit, mund të vërehet dallimi i mjedisit ku zhvillohet ngjarja. Derisa në versionet e popujve të tjerë përshkruhen mjediset fshatare, në versionin shqiptar bëhet fjalë për një ngjarje që zhvillohet brenda një familjeje fisnike, dorën e vajzës e kërkojnë bij fisnikë dhe, djemtë si kalorës fisnikë, vdesin në beteja, për dallim nga versionet e popujve të tjerë, të cilët vdesin nga murtaja.

Kontributi i Dozon-it për folkloristikën shqiptare

Emërimi i August Dozon-it si zëvendës i konsullit të Francës në Janinë në vitin 1869, bëri që krahas detyrave të tij të informimit të qeverisë franceze për gjendjen e vilajetit dhe interesat francezë, të vazhdojë me interesimin e tij edhe për historinë dhe kulturën shqiptare. Me

¹⁷ Luan Rama, *Shqipëria e ...*, f. 37.

veprat e botuara për kulturën shqiptare, si “Manuel de la Langue Chkipe ou Albanaise” (Manuali i gjuhës shqipe apo i shqiptarëve) botuar në vitin 1879, dhe studimin “*Contes albanais*” (Përralla shqiptare) në vitin 1881, në Paris, Dozon kontribuoi në fushën e albanologjisë, sidomos të asaj që ka të bëjë me krijimtarinë gojore e materiale, të mbledhur, të regjistruar dhe të botuar në këto studime, në gjuhën shqipe edhe të përkthyer nga ai në gjuhën frënge. Por, çfarë rrjedhe pati interesimi i Dozon-it për kulturën shqiptare?

Me ardhjen në Janinë, Dozon-i filloi të hulumtojë për historinë e këtij qyteti që e kishte bërë të njohur Ali Pasha i Janinës, por edhe Pouquevill-i si përfaqësues i parë i konsullatës franceze në këtë qytet. Ai u informua edhe për shkollat e Janinës, si ajo Zosimea ku mësonin edhe nxënës shqiptarë, që e njihnin greqishten dhe frëngjishten. Në mesin e këtyre nxënësve, të cilët i ofruan ndihmë Dozon-it në mbledhjen dhe përkthimin e këngëve, proverbave dhe përrallave shqiptare, kryesisht nga Jugu i Shqipërisë, ishte edhe Naim Frashëri, që sapo kishte përfunduar këtë gjimnaz. Një ndihmë dhe mbështetje për kuptimin e kësaj krijimtarie në gjuhën shqipe, të cilën Dozon-i pas ardhjes në Janinë kishte filluar ta mësojë, e mori nga miku i tij iluministi Konstandin Kristoforidhi. Por, ndër ata që ndihmuan më shumë në mbledhjen e folklorit, ishte Apostol Panajot Meksi, i cili së bashku me Kristoforidhin, ishin bashkëpunëtorë edhe të Hahn-it. Madje, siç pohon Dozon-i, Meksi ia kishte dhënë një pjesë të materialeve me përralla për botimin e tij “*Contes albanais*” (Përralla shqiptare)¹⁸.

Në këto vite, interesimi për përrallat si trashëgimi popullore në Evropë ishte i theksuar, gjë e cila dëshmohet nga botimet e shumta, sidomos pas atyre të vëllezërve Grimm, të cilët edhe hapën shteg për kërkime dhe studime të përrallave të popujve të ndryshëm në botë. Dozon-i, i nxitur nga këto botime, e veçanërisht nga vepra e Hahn-it “Studime shqiptare”, po edhe nga botimi tjetër “Përralla greke dhe shqiptare”, në të cilin Hahn-i ka përfshirë 12 përralla shqiptare, edhe pse shumë vite më vonë pas qëndrimit të tij në Epir, të botojë, në vitin 1881, në Paris, studimin “*Contes albanais*” (Përralla shqiptare). Në këtë studim, më të thelluar mbi përrallën popullore shqiptare, Dozoni kishte marrë në shqyrtim përrallat shqipe të mbledhura në Epir dhe botuar më parë në Manualin e Gjuhës Shqipe. Përrallat shqiptare, Dozon-i, i botoi të për-

¹⁸ Luan Rama, *Shqipëria e ...*, f. 82.

kthyerë në gjuhën frënge edhe përkundër vështirësive që pati në përshtatjen e të shprehurit të formës më interesante të përrallës origjinale.

Në studimin e përrallës, Dozon-i bën përshkrimin e mitologjisë shqiptare, ku qeniet e mbinatyrshe shfaqen me karakteristikat e tyre kombëtare dhe për këtë pati mbështetje pos studimit të Hahn-it dhe botimin e Mitkos “Bleta shqiptare”, të botuar në vitin 1878 dhe nga i cili botim për studimin e tij huazoi përrallën “Merimanga dhe brumbulli”. Botimi i Mitkos i shërbeu Dozon-it të bënte përqasjen, për secilën përrallë shqipe qoftë lidhur me fjalorin dhe strukturën e gjuhës, por edhe në përqasjen e tyre me përrallat ballkanike e evropiane. Këto përqasje që i bën Dozon-i, sipas Ramës kanë një interes të veçantë

“... pasi ato i vendosin përrallat shqiptare në kuadrin e krijimtarisë gojore të popujve të tjerë në kuadrin e trashëgimisë ballkanike, evropiane, madje dhe arabe e aziatike, ku nuk mungon të thotë se kjo apo ajo përrallë, “është tipike shqiptare dhe nuk gjendet diku tjetër”¹⁹.

Nga kjo përqasje, Dozon-i vë në dukje se shprehja e fillimit në përrallat shqiptare “Na ishte seç na ishte” është e njëjtë me ato hungareze “Volt nem volt”, por qenë botimin e Mitkos është zëvendësuar me shprehjen “Ka qenë, por dhe mund të mos ketë qenë”²⁰. Këto formula hyrëse, që kanë një rol dinamik të sinjaleve të veçanta dhe që tregojnë se nga të folurit e zakonshëm kalohet në rrëfim të organizuar artistikisht ose për vërtetësinë dhe imagjinativen në përrallë²¹, në botimin “Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, 1635-1912”, vëllimi II, në të cilin është ribotuar “Bleta shqiptare” e Thimi Mitkos, kjo formulë hyrëse si shprehje “Që në ketë mos na jetë” është evidentuar vetëm në tri përralla²².

Botimi më voluminoz i August Dozon-it për folklorin dhe gjuhën shqipe është “Manuel de la Langue Chkipe ou Albanaise” (Manuali i Gjuhës Shqipe apo i Shqiptarëve), botuar nga Ernest Leroux-i, 28, Rue Bonaparte, në vitin 1878, në Paris²³. Ky Manual i Gjuhës Shqipe, në

¹⁹ Luan Rama, *Shqipëria e ...*, f. 217.

²⁰ Luan Rama, *Shqipëria e ...*, f. 89.

²¹ Myzafere Mustafa, *Përralla shqiptare, poetika dhe mitikja* (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2003), f. 248-249.

²² *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, 1635-1912*, vëllimi II, Instituti Folklorit, Tiranë 1961, f. 166 dhe 173.

²³ Auguste Dozon, *Manuel de la Langue Chkipe ou Albanaise*, Éditeur: Ernest Leroux, (Paris: 1878). Internet Archive, i qasshëm në:

gjithsej 470 faqe, përmban në pjesën e parë, pos parathënies edhe përralla, bejte, këngë dashurie, këngë historike dhe këngë të ndryshme, të përkthyer edhe në frëngjisht. Si shtojcë e pjesës së parë, janë përfshirë proverbat, zakonet e dasmës në Përmet, balada e Konstadinit dhe Garentinës e marrë nga botimi i De Radës, fabula të Ezopit, dy mesazhe të komunikimit nga një regjistër familjar dhe indeksi i përrallave. Në pjesën e dytë janë përfshirë gramatika shqipe dhe probleme gjuhësore të shqipes të trajtuara sipas Dozon-it, dhe në pjesën e tretë fjalori shqip-frëngjisht.

Në parathënien e këtij botimi me titull “Letërsia popullore të “shqiptarëve” apo shqiptarët”, botuar më parë si shkrim i veçantë në “Bulletin de correspondance hellénique”, në Paris, në vitin 1878, Dozon-i dëshmon interesimin e vazhdueshëm për kulturën shqiptare e veçanërisht për krijimtarinë gojore dhe gjuhën, ku thekson, se:

“Kështu, duke përfituar nga një qëndrim i zgjatur në Epir, në fillim për të mbledhur dhe pastaj për të përfshirë gjithë dokumentet në botimin e një libri, qëllimi im kryesor ishte t’u jepja etnografëve dhe filologëve disa elemente më shumë për zgjidhjen e këtij problemi. Të mblidhja përralla, këngë, proverba, kjo ishte gjithçka që doja të bëja në fillim”²⁴.

Por, për përgatitjen e këtij libri për botim, Dozon-it iu desh që pos grumbullimit të materialit empirik të trashëgimisë shpirtërore të shqiptarëve, të mësonte leksikun dhe gramatikën e shqipes, të hartonte një fjalorth dhe nga kërkimi i strukturës gjuhësore të proverbave të kuptonte edhe pasurinë e gjuhës shqipe, për të cilën punë e ndihmuan pos Kristoforidhit e Mitkos edhe rilindasit De Rada, Kamarda, Jubani, bashkëkohësit dhe bashkëpunëtorët, si: Hecquard-i, Robert-i, Dumont-i, Leger-i etj., por edhe me pararendës të tij në këtë fushë studimi, si: Xylander-i, von Hahn-i, Reinhold-i etj..

Edhe përkundër studimit dhe konsultimit të veprave të këtyre veprimtarëve nga ana e Dozon-it, qofshin shqiptarë apo të huaj, për studimet e mëvonshme shqiptare, e veçanërisht për ato të folkloristikës, mbesin të paarsyeshme disa konkludime kategorike që thuhet në parathënien e Manualit të tij, sidomos kur tregohet kategorik për disa çështje, si “... asnjë shqiptar i Turqisë, me përjashtim të Kristoforidhit, nuk ka menduar ende mbi gjuhën e tij, se ai nuk di ta shkruajë dhe se nuk

<https://archive.org/details/manueldelalangu01dozogoog/page/n23/mode/2up> [qasur në: 20 .09. 2021]; si dhe Auguste Dozon, *Manuel de la Langue Chkipe ou Albanaise*, Éditeur: Ernest Leroux, (Paris: 1879). Arkivat digjitale Shkodër, i qasëm në: <http://adsh.unishk.edu.al/items/show/749> [qasur në: 20 .09. 2021].

²⁴Luan Rama, *Shqipëria e ...*, f. 115.

beson se mund t'i jetë e dobishme si gjuhë". Ky konkludim i Dozon-it, konsiderohet i paarsyeshëm sidomos për faktin se pos Kristoforidhit (të cilin e kishte bashkëpunëtor të afërt dhe i cili që në vitin 1866, kishte botuar "Alfavitari shqip" (Alfabetin shqip), ndërsa në vitin 1872 një libër për fëmijë ku abetarja ilustruhej me pjesë këndimi), ai do të ketë qenë në dijeni për kontributin edhe të një varg veprimtarësh e shkrimtarësh të Periudhës së Rilindjes në kulturën shqiptare. Mu për këtë arsye Rama konsideron se "Dozon-i në këtë pikë duket disi kategorik dhe duhet kuptuar se ai nuk arriti ta njihte tërësisht tabloun e përpjekjeve të mëdha shqiptare në këtë drejtim, çka do t'i mësonte ndoshta më vonë"²⁵.

Po kaq kategorik, Dozon-i tregohet edhe me përrallat shqiptare, ku thotë se me përthimin e përrallave shqipe ai ofron edhe një indeks për ata që merren me mitologjinë krahësimtare, por që "këto përralla do t'i zhgënjëjnë ata persona që kujtojnë se do të gjejnë një afresk të zakonave e sidomos tradicionet e shqiptarëve", të cilat ai pretendon t'i gjejë në përralla. Duhet theksuar se këto karakteristika zakonore që Dozon-i i kërkon në përrallë, janë të shpërfaqura në zhanre të tjera të krijimtarisë gojore, qofshin në këngët epike, baladat, këngët e nizamëve, të mërgimit, të kaçakëve, në gjamën e burrave dhe vajet, dhe të evidentuara edhe nga mbledhës të hershëm shqiptarë. Prandaj për vëllimin I, "Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar (1635-1912)" ky vlerësim kategorik i Dozon-it konsiderohet i nxituar dhe përgjithësuar për faktin se ai ka pasur në dorë një material të kufizuar të krijimtarisë sonë gojore²⁶.

Ndër materialet e krijimtarisë gojore që mbledhi dhe botoi Dozon-i do të veçonim me këtë rast për trajtim 59 proverbat e Manualit ... të tij, të cilat janë të radhitura sipas zonës së cilës i përkasin, si nga zona e Fierit, nga Frashëri dhe nga Korça. Numri më i madh nga këto proverba, janë nga Frashëri, të cilat i mbledhi Naim Frashëri dhe ia transmetoi Dozon-it, prandaj edhe mund të konsiderohen si të sakta për faktin se ai njihte mirë dialektin e vendlindjes së tij dhe atë çam. Proverbat, të cilat i botoi Dozon-i, mund ta kenë ndihmuan atë edhe në studimin e gjuhës shqipe, sepse këto forma të shkurtra të krijimtarisë gojore kanë rëndësi jo vetëm për folkloristikën, por edhe për leksikografinë e dialektologjinë e një gjuhe, dhe në të cilat krijime reflektohet prirja artistike, shprehja figurative, si dhe frazeologjia e tyre e pasur. Prandaj, për studimet që u qasen proverbave apo fjalëve të urta nga aspekti gjuhësor, ato janë fraza verbale

²⁵ Luan Rama, *Shqipëria e ...*, f. 127.

²⁶ *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, 1635-1912*, vëllimi I, f. 255.

në të cilat mund të analizohen marrëdhëniet midis gjuhës, mendimit dhe kulturës²⁷.

Po t'u qasemi nga aspekti paremiologjik këtyre proverbave në zonat ku janë mbledhur, na shpërfaqen një mori rregullash të marrëdhënieve të përditshme dhe të zakonshme, e shpesh të ndërlikuara ndërmjet njerëzve si qenie subjektive dhe shoqërore, sado që si rregulla janë të përgjithshme për njerëzimin. Prandaj paremiologjia proverbat i përkufizon si fraza verbale të përhershme, të cilat nuk ndryshojnë gjatë rrëfimeve të ndryshme, dhe kjo karakteristikë e tyre mund të dëshmohet edhe me proverbat e botuara në Manualin e Dozon-it, të cilat vazhdojnë të jenë prezentë në komunikimin e përditshëm në kulturën shqiptare, si p.sh. ato: “Qeni që leh nuk kafshon.”; “I buti, i humti.”; “U doq plaka nga qulli, i fryn edhe kosit.”²⁸ etj., dhe na bën të nënkuptojmë se porosia e tyre e kumtuar si tekst i zgjedhur nga ana e rrëfimitarit edhe atëherë, ka patur qëllim të argëtojë, mësojë, e informojë për të ndryshuar qëndrimet shoqërore e sociale. Siç mund të vërejmë edhe nga këta shembuj nga manuali i Dozonit, proverbat mbesin të përhershme dhe domethënia e tyre kuptohet me dëgjimin dhe përdorimin e shpeshtë të tyre, sepse e ndryshueshme është vetëm mënyra e interpretimit dhe përdorimi i saj në situata të ndryshme.

Nga analiza e funksionit të rrëfimit të proverbave të manualit të Dozon-it, konstatojmë se ato në radhë të parë dëshmojnë vlera për nga synimi didaktik e etiko-moral, që shpërfaqen në këto tekste verbale përmbajtjesore, të pasura me metafora e simbole dhe me gjuhë karakteristike dialektore të zonave të cilave u përkasin. Për shembull, proverbat, si: “Mos shuaj zjarrmin me vaj.”; “Pyet shtatë e vepro si di vetë.”; ose “Tjatëri hëngri fiqtë, tjatëri i pagoi.”, të krijuara nga një përvojë jetësore shumë kohë më parë dhe të përdorura brenda një komunikimi dhe konteksti tjetër, mund të konstatojmë se bashkëbiseduesi ka zgjedhur të vërtetën, jo nga kuptimi i fjalëve të përdorura, por nga rëndësia e përdorimit të proverbit nga rrëfyesi në bashkëbisedim. Disa nga këto proverba shprehin marrëdhëniet etike midis njerëzve në situata të ndryshme,

²⁷ Alessandro Duranti, *Linguistic Anthropology* (New York: Cambridge University Press, 1997), f. 398. Google ebook <https://www.academia.edu/6505213/Linguistic_Anthropology_Duranti> [qasur 05/10/2020].

²⁸ Këta shembuj proverbash dhe të tjerat në vazhdim, janë marrë nga monografia: Luan Rama, *Shqipëria e konsullit August Dozon*, (Tiranë: Botimet Ngjyrat e Kohës, 2014), f. 179-181; dhe nga *Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, 1635-1912*, vëllimi I, f. 318-319.

si p.sh.: “Tek s’ke dhënë, mos merr.” ose “Ç do berr më këmbë të tija varet.” etj., të cilat u kanë mundësuar bashkëbiseduesve, që për të zbutur realitetin, të shfrytëzojnë përvojën e urtë të trashëguar nga gjeneratat e mëparshme.

Proverbat e Manualit të Dozon-it nga ana e përmbajtjes kuptimore shpërfaqin edhe forcën udhëzuese me të cilën është strukturuar sjellja shoqërore e përdoruesve të saj dhe drejtuar si sjellje dhe veprim në vazhdimësi ndër gjenerata të ndryshme, të banorëve në zonat ku janë krijuar dhe mbledhur. Nga këto proverba mund të vërejmë se ato udhëzojnë kryesisht në sjelljet edukative të njeriut në raport me maturinë: “Fol çdo, prit ç’mos do.”; me durimin: “Kush duron, trashëgon.”; me respektin ndër gjenerata: “Dardhë më dardhë do të vejë.”; me miqësinë: “Si miku edhe mesniku.”; me mençurinë: “Kush s’ka kokë, ka këmbë.”; me zgjuarsinë: “Kur ke mashënë, pse djek dorën.”; me sy çeltësinë: “Lumi fle, hasmi s’fle.”; edukatën: “Kur s’të pyesin, mos fol.”; me gjindshmërinë: “Duke pyetur gjen Stambollë.”; me rregullsinë: “Një dorë lan tjetërën, të dyja suranë.”; me respektin: “Gjetkë më ha, gjetkë më kruan.”; me dembelinë: “S’do të korç, mbliith urof.”; me punën: “Gusht e gunë, vjesht’ e lugë.”; me dukuri të këqija: “Peshku qelbet nga koka”; e të tjera.

Siç mund të vërejmë nga shembujt e mësipërm të proverbave të botuara në Manualin e Dozonit, vlera e tyre qëndron në atë që ky *albanist* u ofroi lexuesve të huaj, që nga këto krijime të shkurtra gojore të kulturës tradicionale shqiptare, të mund të zbulojnë mendimin e formuar nga një përvojë jetësore brenda një grupi të caktuar, një regjioni, ose edhe të popullit në përgjithësi.

Përfundim

Në përfundim të këtij punimi, që pati në fokus trajtimi dy botime të albanologëve të huaj, atë të Reinhold-it dhe Dozon-it, të cilat edhe pse në radhë të parë kanë të përbashkët analizën filologjike, konkretisht të dialektit jugor të shqipes, përmbajnë njëkohësisht edhe materiale empirike të kulturës tradicionale, nga të cilat botime veçuan interesimin dhe kureshtjen studimore që treguan këta albanologë për të trajtuar, në veçanti, krijimtarinë gojore shqiptare. Pasioni i tyre për mbledhjen dhe botimin e krijimeve gojore nga hulumtimet e bëra brenda një gjeografie hapësirash të banuara me shqiptarë në një kohë të caktuar dhe duke

shpërfaqur me raste vlerat e saj edhe në plan krahasues me kulturat e tjera ballkanike, sidomos kur studiohet nga një tjetër i huaj, thellon rëndësinë edhe për faktin, se këto vlera ua bënë të njohura me botimet e tyre lexuesve dhe studiuesve të huaj. Sado që nga këndvështrimi i sotëm i realiteteve dhe niveleve të dijes, kontributi i tyre mund të keqkuptohet, kur me trajtesat, shqyrtimet dhe arsyetimet parashtrajnë realitete folklorike me aq materiale sa arritën të grumbullojnë dhe mbi të cilat pohojnë apo mohojnë pikëpamje të pavërtetuara përfundimisht, kontributi i tyre mbetet një dëshmi për folkloristikën shqiptare dhe hap shteg për studime të mëtejme.

APPROACH TO ALBANIAN ORAL CREATIVITY

PUBLISHED BY OTHERS

Summary

Traditional Albanian culture became an object of ethno-folklore research for many travellers, missionaries, scholars, writers, anthropologists, and various consuls serving in the Balkans during the 19th century. The published writings of these missionaries and personalities of foreign cultures on the history of Albanian culture at that time, either in English, German or French, became the basis for the beginning of the rise of Albanian studies, not only of linguistical and historical aspect, but also of the traditional culture.

This paper will address the contribution of two foreign albanologists, that of the German medical doctor and philologist Karl Heinrich Theodor Reinhold with the publication "*Noctes pelasgicae*" published in 1855, in Athens, and that of the French consul Auguste Dozon, with the publication "*Manuel de la Langue Chkipe ou Albanaise*" published in 1879, in Paris. The purpose of bringing these two albanological publications back into focus of consideration is that, in addition to having in the first place a common analysis in the philological aspect, specifically of the southern dialect of Albanian language, at the same time they also contain empirical materials of the traditional culture, from which we try to distinguish some of those oral creations containing substantial values for the Albanian folkloristics, as well as what is the consideration given

to these creations from the point of view of the other, even though sometimes seem to be hasty in the conclusions they draw on the basis of a limited empirical material, especially for the given time and space where those folklore units had been gathered.

Bibliografia

Bardhoshi, Nebi, Arsim Canolli, Kosova antropologjike, *Albanologji I/11-2020*, (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2021), 328-352.

Berisha, Anton, 'Fillet e njohjes së letërsisë gojore shqipe në gjuhën gjermane', *Gjurmime albanologjike, seria Folklor dhe etnologji*, XVI (1985), (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1986), 7-26.

Doja, Albert, 'Lindja e Albanologjisë sipas shkrimeve gjermane dhe austriake', *Gjurmime Albanologjike, seria Folklor dhe etnologji*, 46/2016, (Prishtinë: Instituti Albanologjik, 2016), 9-39.

Doja, Albert, *Shfaqja e antropologjisë në Shqipëri*, përgatitur nga Enika Abazi, (Tiranë: Akademia e shkencave e Shqipërisë, 2018).

Dozon, Auguste, *Manuel de la Langue Chkipe ou Albanaise*, Éditeur: Ernest Leroux, (Paris: 1878). Internet Archive, i qasshëm në: <https://archive.org/details/manueldelalanguoidozogooog/page/n23/mode/2up> [qasur në: 20 .09. 2021].

Dozon, Auguste, *Manuel de la Langue Chkipe ou Albanaise*, Éditeur: Ernest Leroux, (Paris: 1879). Arkivat digjitale Shkodër, i qasshëm në: <http://adsh.unishk.edu.al/items/show/749> [qasur në: 20 .09. 2021].

Duranti, Alessandro, *Linguistic Anthropology* (New York: Cambridge University Press, 1997), Google ebook <https://www.academia.edu/6505213/Linguistic_Anthropology_Duranti> (qasur 05/10/2020).

Kastrati, Jup, *Historia e Albanologjisë* (Tiranë: Botimet LMG-Shtëpia e librit, Fondacioni Soros, 2000).

Kosova antropologjike, edituar nga Nebi Bardhoshi, Arsim Canolli (Tiranë: Akademia e studimeve albanologjike, Instituti i antropologjisë kulturore dhe i studimit të artit, 2020), f. 7-50.

Klosi, Ardian, *Netë Pellazgjike të Karl Reinholdit*, Tekste të vjetra shqipe të Greqisë, mbledhur nga Karl Reinholdi 1850-1860, (Tiranë: K&B, 2005).

Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, 1635-1912, Vëllimi I, (Tiranë: Instituti i Folklorit, 1961).

Mbledhës të hershëm të folklorit shqiptar, 1635-1912, Vëllimi II, (Tiranë: Instituti i Folklorit, 1961).

Mustafa, Myzafere, *Përralla shqiptare, poetika dhe mitikja*, (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2003).

Neziri, Zymer, 'Poetika e krahasimit erotik për vashën në këngën popullore shqiptare të dashurisë', *Gjurmime albanologjike, Folklor dhe etnologji, Nr. 17-1987*, (Prishtinë: Instituti Albanologjik i Prishtinës, 1988), 127-153.

Rama, Luan, *Shqipëria e konsullit August Dozon*, (Tiranë: Botimet Ngjyrat e Kohës, 2014).